



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 48 Datë 13.06.2023

“Për zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit bashkiak në Këshillin e Qarkut Shkodër”

Mbështetur në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 48, **Mbledhja e parë e këshillit bashkiak**, pika 5, *Mbledhja e parë e këshillit, deri në zgjedhjen e kryetarit të tij, drejtohet nga këshilltari më i vjetër në moshë*; pika 6, gërma d) *zgjidhen anëtarët që do të përfaqësojnë këshillin bashkiak në këshillin e qarkut dhe pajisen me mandatin e përfaqësimit*; neni 54, **Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak**, gërma i) *zgjedh përfaqësuesit e këshillit bashkiak në këshillin e qarkut, të cilët, në jo më pak se 50 për qind të tyre, duhet t’i përkasin gjinisë më pak të përfaqësuar*; neni 55, **Votimi**, pika 3, *Vendimet merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “f”, “g”, “gj”, “i” dhe “j”, të nenit 54, të këtij ligji*; neni 72, **Përbërja e Këshillit të Qarkut**; neni 73, **Përcaktimi i numrit të anëtarëve të këshillit të qarkut**, pika 1, *Numri i përfaqësuesve të bashkive në këshillin e qarkut caktohet në përpjesëtim me numrin e popullsisë, si më poshtë: Bashkitë me popullsi 50 001 deri në 100 000 banorë, 5 përfaqësues*; Këshilli i Bashkisë Vau Dejës, në mbledhjen e tij të parë;

VENDOSI:

- Zgjedhjen e përfaqësuesve të këshillit bashkiak Vau Dejës në Këshillin e Qarkut Shkodër, me shumicë të votave, mbështetur në nenin 55, pika 3, të Zj. Kristjana Kovaçi, Z. Arsen Mehmeti, Z. Ermir Tahiri, Zj. Mirela Vasija.
- Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Ardian CELEPIJA

Kryetari i Këshillit
Ervis SHIMAJ

Miratuar me 27 vota

Znj. Kristjana Kovaçi 22 vota pro
Z. Arsen Mehmeti 20 vota pro
Z. Ermir Tahiri 19 vota pro
Znj. Mirela Vasija 16 vota pro
Zbardhur me datë 16.06.23